

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GLLOGOC-në procedurën kundërvajtëse të zhvilluar kundër të pandehurit Nexhmedin Misin Bala nga fshati Korroticë e Epërme-Komuna e Gllogocit, për veprën kundërvajtëse të kryer nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, e në vështrim të neneve 73,195, 199 dhe nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datën 09.10.2012 mori këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Nexhmedin Misin Bala i lindur më datën 07.11.1974 në Korroticë të Epërme, ka të kryer Fakultetin e kulturës Fizike-Master, profesor, i martuar baba i dy fëmijëve, Shqiptar, shtetas i Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë jo i dënuar dhe jo nënë hetime, e me vendbanim të përhershëm në fshatin Korroticë e Epërme- Komuna e Gllogocit.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse me datën 02.07.2012 i pandehuri Nexhmedin Bala, zyrtar i lartë publik, nuk ka përmbushur obligimin ligjorë që parashihet me ligjin nr.04/L-050, për deklarimin, prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, me këtë veprim i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë. Andaj:

I S H Q I P T O H E T

MASA QORTIM GJYQSORË

Shpenzime të procedurës kundërvajtëse nuk ka pasur.

Më një kopje të këtij aktvendimi njoftohet i pandehuri dhe paraqitësi i kërkesës. DPK / DMP 03-3866/12

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, me kërkesën e vetë nr. 01-2360/12 të datës 02.07.2012 ka kërkuar që të zhvillohet procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Nexhmedin Misin Bala nga fshati Korroticë e Epërme-Komuna e Gllogocit, për veprën kundërvajtëse të kryer nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë

Gjendja faktike dhe reale u vërtetua pas dëgjimit të t' pandehurit Nexhmedin, të personit të autorizuar zyrtarë përfaqësuesit të Agjencionit Kundër Korrupsioni Agron Behrami, zyrtarit Komunal KK-Gllogoc, Ali Berisha dhe ballafaqimit të të pandehurit Nexhmedin me përfaqësuesin e Agjencisë Kundër Korrupsionit Agron Behrami, në seancën gjyqësore të mbajtur me datën 04.10.2012.

I pandehuri Nexhmedin Bala deklaroi se vërtet unë nuk e kam deklaruar pasurinë me kohë për arsye se kam qenë në shoqërim të djalit të motrës, nipit tim në Shqipëri i cili ka vuajtur nga një sëmundje e rëndë dhe tani i ndjeri ka vdekur dhe për këtë nuk kam pasur mundësi në atë kohë të vijë që ta lajmëroj pasurinë në Agjencionin Kundër Korrupsion, si zyrtar i lartë, por këtë e kam bërë pasi kam ardhur nga Tirana, meqë në seancë gjyqësore e prezantoj vërtetimin që e kam deklaruar pasurinë por atë me vonesë. Unë nga Tirana kam lajmëruar në telefon Agjencionin dhe në telefon kam folur me një zyrtarë të këtij Agjencioni, ku e njëjta më ka thënë që pasi të vishë eja e lajmëroj edhe pse kundërvajtja është kryer.

Përfaqësuesi ligjorë i Agjencionit Agron Behrami deklaroi se i pandehuri Nexhmedin e ka lajmëruar pasurinë por pas afati ligjorë, ne e kemi dërguar një shkresë zyrtare në Komunën e Gllogocit, në mënyrë që përfaqësuesi i tyre ti lajmërojë të gjithë zyrtarët e lartë, për afatin ligjorë kur zyrtarët e lartë janë të obliguar ta paraqesin pasurinë e tyre në Agjencion, mirëpo Nexhmedin Bala, tani i pandehuri nuk e ka lajmëruar pasurinë me kohë dhe për këtë ne i kemi bërë kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Është e vërtetë se ky e ka lajmëruar pasurinë por me vonesë, pasi ka kaluar afati ligjorë edhe kundërvajtja është kryer.

Gjykata pasi e dëgjoj të pandehurin Nexhmedin dhe përfaqësuesit ligjorë të Agjencionit Kundër Korrupsion, erdhi në përfundim dhe konstatoi se i pandehuri Nexhmedin e ka përmbushur obligimin ligjorë duke informuar Agjencionin Kundër Korrupsioni por me vonesë, dhe për këtë Gjykata duke pasur për bazë atë se duke pasur për bazë atë se i pandehuri për shkakë

&

objektive dhe subjektive nuk ka mundur të përmbush obligimin ligjorë në afatin ligjorë por e ka bërë me vonesë me çka ka ofrua dëshminë për deklarim të pasurisë, vërtetimin e lëshuar nga Agjencioni Kundër Korrupsion me nr.DP-03-3474/12 të datë 10.05.2012.

Gjykata mori për bazë faktin se i pandehuri gjatë kohës kur ka qenë afati për deklarimin e pasurisë ka qenë në spitalin Tiranës për të shoqëruar nipin e tij, djalin e motrës dhe tani të ndjerin Shpetim Istogu, ku për këtë ka sjellur vërtetimin e spitali të datës 12.04.2012.

Gjatë shqyrtimit Kryesor Gjykata vërtetoi faktin se përfaqësuesi i Komunës Ali Berisha, theksoj se ne edhe pse kemi qerë të obliguar të informoj zyrtarin e Lartë, tani të pandehurin Nexhmedin, **nuk kemi pasur mundësi ta informojmë dhe nuk e kemi informuar sepse i njëjti ka qenë në Tiranë**, dhe nuk kemi pasur qasje në telefon e as në adresë elektronike nuk e kemi informuar

Si rrethanë tjetër për ti dhënë masën Qortim Gjyqësorë, Gjykata mori për bazë atë se i pandehuri e ka përjetuar rëndë humbjen e nipit të tij, se edhe për kundër kujdesit i njëjti ka vdekur ku i pandehuri edhe gjatë marrjes në pyetje e ka përjetuar rëndë humbjen e nipit të tij, me çka ka theksuar se nuk dëshiroj që me fatkeqësinë e tij, ti iku dënimit por e vërtet është që ka qenë në Tiranë për ta shoqëruar dhe pasi kam ardhur nga Tirana menjëherë kam shkuar në Agjencion për të deklaruar pasurin dhe e kam kryer obligimin ligjorë edhe pse pas afatit.

Duke u bazuar në këto fakte dhe prova të argumentuara, të secilës provë veç e veç të gjitha provave dhe procedurës së përgjithshme, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme, e të kujdesshme, Gjykata erdhi në përfundim dhe konstatoj se pandehur ka kryer vepër kundërvajtëse të deklarimit me vonës të pasurisë dhe duke u bazuar në rrethanat dhe provat lartshënuara erdhi në përfundim dhe konstatoj se shqiptimi i masës Qortim Gjyqësorë në vështrim të nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtje është në proporcion me peshën e veprës kundërvajtëse të kryer, shkallen e përgjegjësisë e duke konsideruar se edhe me një masë të tillë do të arrihet efekti pozitiv tek i pandehuri dhe në rrethinën e tij.

Me sa u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa me afat prej 8 ditësh, pas marrjes së të njëjtit Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.

Gjyqtari

Daut Qela

